

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Debati për pagat e gjyqtarëve, Ylli Manjani del në krah të ministrit Malaj: Thesarin e Shtetit nuk e merr pe ng politika dhe drejtësia
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/debati-per-pagat-e-gjyqtareve-ylli-manjani-del-ne-krah-te-ministrit-mal-i401103
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 11:44:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 11:39:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	eecca10c9e5ccd0ab31dcf1ff79a1c32b2de39d2c8ea6f969cc7e533b87d46e7
TEKSTI	d73de0d5215303575e430e2305d3947993ca618152f01064df72f7be20b2246bb
PAMJA	f3d812dee3e3fed5c049b56b0228473d24e23f8d0cc9aec2dde5772d16640ba9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	755d58da866be2c453af54a62c0afbeb33bc1782a26a3e3430521292d087647c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	f7fe3484a9a9000951d0319deb7eab25f99edd91b8ae32dfd23370158c045acee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/755d58da866be2c453af54a62c0afbeb33bc1782a26a3e3430521292d087647c

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Politikë

13 Shtator 2026, 13:39

Debati për pagat e gjyqtarëve, Ylli Manjani del në krah të ministrit Malaj: Thesarin e Shtetit nuk e merr peng politika dhe drejtësia

 Shkruar nga Newsbomb


Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, ka reaguar sërish në lidhje me debatet e shkaktuara për shkak të bllokimit të pagave të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore në Thesarin e Shtetit nga ana e qeverisë.

Në një postim në rrjetet sociale, Manjani ka dalë në mbrojtje të ministrit të Financave, Petrit Malaj, për të cilin shkruan se nuk e njeh, por vlerëson rezistencën e tij për të mos lejuar futjen e duarve në Thesarin e Shtetit.

Ish-ministri shkruan më tej se, me vendimin e marrë nga magjistratët, Shqipëria ka dalë nga shteti kushtetues.

"Një pushtet i tërë ka braktisur rolin e tij kushtetues dhe është shndërruar në një sindikatë që merr vendime për interesin e vet. Kjo nuk është drejtësi. Kjo është sindikalizëm institucional", thekson ai.

Ndërsa, sa i përket kallëzimit në SPAK të Malajt, Manjani shkruan se kjo mund të sjellë një përplasje institucionale.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Nga shija e detit të "Tempulli i Shpirtit"! Hap dyert "Fish City Apollonia", restoranti i Gjergj Lucës ku Fishta, Konica e Nënë Tereza "rilindin" në kujtesën shqiptare



Rajoni

Kosova drejt formimit të qeverisë, Albulena Haxhiu dekreton Albin Kurtin si kryeministër! Sot pritet të votohet në Kuvend

Zbulo më shumë artikuj >

"Ta çojmë deri në fund këtë logjikë absurde. Supozojmë se sindikata e drejtësisë heton ministrin. E arreston. E dënon. Me cilën polici do ta zbatojë vendimin? Me Policinë e Shtetit, që është pjesë e ekzekutivit? Në cilin burg do ta çojë? Kush do ta ekzekutojë një vendim të marrë në një gjendje lufte ndërmjet pushteteve?", shkruan ai.

Postimi i plotë:

Nuk e njoh Petrit Malajin si person. Nuk kam asnjë ide të veçantë se si është si ministër, sa mirë apo sa keq e ka bërë detyrën e tij. Por për një gjë nuk kam asnjë mëdyshje: për rezistencën e tij për të mos lejuar futjen e duarve në Thesarin e Shtetit sipas qejfit të gjykatësve dhe prokurorëve, unë jam me Petrit Malajin.

Prej dy javësh Shqipëria po sheh një reagim që nuk ka asgjë të përbashkët me funksionimin normal të një shteti kushtetues. Një pushtet i tërë ka braktisur rolin e tij kushtetues dhe është shndërruar në një sindikatë që merr vendime për interesin e vet. Kjo nuk është drejtësi. Kjo është sindikalizëm institucional.

Thesari i Shtetit nuk është kasaforta e një pushteti. Është institucioni ku ekzekutohen pagesat që urdhëron ligji. Pikërisht ligji. Jo vendime që burojnë nga interesi i atyre që i marrin. Në një shtet normal, askush nuk i jep vetes të drejtën të urdhërojë pagesa publike jashtë mekanizmit ligjor. Aq më pak pushteti që duhet të jetë arbitri i ligjit. Edhe i famshmi vendim me numër 15, i Gjykatës Kushtetuese bëhet i zbatueshëm vetëm pasi e njeh ligji dhe, jo sindikata antikushtetutë e drejtësisë.

Ajo që po ndodh është e paprecedentë. Gjykata merr vendim për t'i thënë ministrit të Financave: hap Thesarin dhe pagua sipas vendimit tonë. Praktikisht i kërkohet ekzekutivit të dorëzojë çelësat e arkës së shtetit një pushteti tjetër, pa ligj të Parlamentit. Ky nuk është kontroll dhe balancë pushtetesh. Ky është grabitje kompetence kushtetuese të një organi tjetër, me qëllim për të grabitur thesarin e shtetit.

Në tridhjetë e katër vite punë me ligjin nuk kam parë një situatë të tillë. Mund të kem parë vendime të gabuara, interpretime të diskutueshme, edhe abuzime. Por që një pushtet të përdorë autoritetin e tij për të vendosur mbi pagën e vet dhe pastaj të kërkojë ekzekutimin me forcë të këtij vendimi, kjo është një ngjarje me përmasa të jashtëzakonshme.

Po, cinikisht më vjen në mendje shprehja: "Ata që e bënë këtë reformë, ja pafshin hajrin." Sepse reforma që premtoi drejtësi po prodhon një drejtësi që sillet si korporatë me privilegje. Por cinizmi nuk mjafton. Përpara tij qëndron detyrimi për të mbrojtur rendin kushtetues.

E di që do të dalin formalistët. Ata që do të thonë se çdo vendim gjykate duhet zbatuar verbërisht. Por pyetja është shumë më e rëndë: çfarë ndodh kur një pushtet përdor kompetencën e tij për të vendosur harbutërisht për xhepin e vet? Çfarë ndodh kur po ai pushtet nuk jep llogari askund për vonesat, për shërbimin që nuk ofron, për dosjet që zvarriten, për qytetarët që presin vite për një vendim?

Sundimi i ligjit nuk do të thotë sundimi i një pushteti mbi të tjerët. Do të thotë që secili pushtet qëndron brenda kufijve që i vendos Kushtetuta.

Pagat publike nuk i cakton sindikata. Nuk i cakton gjykata për veten e saj. I cakton ligji. Dhe Thesari i Shtetit nuk paguan sipas dëshirës së askujt; paguan sipas ligjit.

Më shqetësuesja është kërcënimi me ndjekje penale ndaj ministrit që refuzon të veprojë jashtë ligjit. Këtu konflikti nuk është më për paga. Është për vetë shtetin.

Ta çojmë deri në fund këtë logjikë absurde. Supozojmë se sindikata e drejtësisë heton ministrin. E arreston. E dënon. Me cilën polici do ta zbatojë vendimin? Me Policinë e Shtetit, që është pjesë e ekzekutivit? Në cilin burg do ta çojë? Kush do ta ekzekutojë një vendim të marrë në një gjendje lufte ndërmjet pushteteve?

Kjo është rruga drejt një përplasjeje institucionale që nuk mbahet mend në asnjë model shteti demokratik.

Prandaj unë jam pa asnjë ekuivok me qëndrimin rezistues të Petrit Malajt. Jo sepse mbroj ministrin. Jo sepse mbroj qeverinë. Por sepse mbroj një parim shumë më të madh se

emrat. Mesazhi i shtetit nuk mund të merrte peng nga akuzat, as nga politika e re as nga drejtësia.

Nëse sot pranojmë që një pushtet të urdhërojë pagesa për veten e tij, nesër nuk do të kemi më ndarje pushtetesh. Do të kemi një pushtet që gjykon, vendos, urdhëron pagesën dhe kërcënon penalisht këdo që nuk bindet.

Më keq akoma do kemi një shtet në kaos financiar. As te shteti i Sudes nuk ka ndodhur ky kaos që sugjeron pushtetit sindikalist i drejtësisë.

Ky nuk është sundim i ligjit.

Ky është sundim i sindikatës antikushtetutë mbi shtetin. Është një antikushtetutshmëri që nuk ka se si ta konstatojë një gjykatë që e ka shkaktuar atë!

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Diel 11:41

Ngërçi i krijuar pas bllokimit të pagave të magjistratëve, Rama: Atmosferë shqetësuese! Pavarësia e gjyqësorit ka arritur në papërgjegjshmëri



Politikë

Nga Fieri, Vlora dhe Korça, Rama njofton hapjen e 4 universiteteve të reja: Do të jenë me reputacion ndërkombëtar


E Diel 10:21



Politikë

Të dytët në Ballkan, Rama reagon sërish për ngërçin e pagave të magjistarëve: Kemi rrogat më të larta se në Greqi për gjyqtarët fillestarë

E Diel 09:39





E Shtunë 21:49

Klodiana Spahiu më “dorë të hekurt” te Shëndetësia, LARGON nga detyra drejtoreshën e Sterilizimit pasi dha tenderin 50 milionë euro të dializës



Politikë

Rama ndan PAMJET nga takimi informues në Gjirokastrë, kryeministri u shpjegon qytetarëve si do të funksionojë Reforma Territoriale

E Shtunë 18:18



Politikë

Rama “zbarkon” në Vlorë, pritjet e takojë qytetarët për “Territoriale”, ndalet edhe te ish-parku Aulona

E Shtunë 16:27



E Shtunë 16:12

“Duan edhe ‘të prapambeturat’ që nga prilli 2023!” Rama “bën sërish llogaritë” pas vendimit të Administrative: Shkojnë rreth 130.5 milionë euro



Politikë

Prokurori nuk mban më, ironizon Edi Ramën: Kur shteti mbetet në dorën e



Politikë

“Farsa është në ditët e fundit”, Edi Rama në mbështetje të çlirimtarëve:

piktorit, ligji kthehet në Penel
(KOMENTI I PLOTË)

E Shtunë 12:02

Hashim Thaçi do të triumfojë me
forcën e të vërtetës së tij

E Shtunë 11:22



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.